


PROKURORIA E PLOTFUQISHËM  
 PRAVNOBNAZNA  
 TEMELORE / OSNOVNI SUD  
 FERIZAJ / UROSEVAC

08 - 03 - 2018



## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm-  
 Divizioni Penal-** në përbërje prej gjyqtarit individual Elmaz Zenuni, me Zyr.ligjor Gazmend Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna e Suharekës, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr. 1329-1/2017 të datës 27.07.2017, për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me Kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr. 1329-1/2017 të datës 27.07.2017, për dhënjen e Urdhërit Ndëshkimor, më datën 09.01.2018 mori:

## AKTGJYKIM

**PRANOHET** Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr. 1329-1/2017 të datës 27.07.2017, gjykata jep:

## URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri, [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna e Suharekës, e lindur më [REDACTED] nga babai [REDACTED] ka të kryer shkollën fillore i gjendjes së varfër ekonomike, shtetas i Republikës së Kosovës.

## ËSHTË FAJTORE

Sepse më datën 12.07.2017 rreth ores 10:40 në pyllin public në vendin e quajtur "Paralelja 24" në Rajonin e Ekonomisë Pyjore, Nerodime –jezerc është takuar duke prerë 1 copë dru trung të ahut të njom me diameter 55 cm, bonitet III, me vëllim të përgjithshëm 2.30 metra kub, në vlerë prej 310.50 euro,

**Me të cilën ka kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPRK-së dhe neneve 365 e 495 të KPPRK-së të pandehurin gjykata e:

## GJYKON

**DENIM ME GJOBË** në lartësi prej 200 euro (me shkronja dyqind euro) i cili denim ekzekutohet në afat prej 15 dite nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burg.

Obligohet i pandehuri që në emër të kërkesës pasuroro-juridike të dëmtuarës DBP-zyra në Ferizaj të i kopesojë dëmin e shkaktuar të dispozitivit të këtij aktgjykimi në shmën prej 310.50 Euro (me shkronja: pesqind e dhjetë euro e njëzetë e dhjetë cent) në afat prej 15 dite nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë nën kërcënim të ekzekutimit me detyrim .

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

## ARSYETIM

Prokurorisë Themelore në Ferizaj me akuzën e vetë PP/II nr. 1329-1/2017 të datës 27.07.2017, ka akuzuar të akuzuarin [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së, e njashtu, ka ushtruar Kërkesë për dhënjen e Urdhërit Ndëshkimor PP/II nr. 1329-1/2017 të datës 27.07.2017 me arsyetim se ka prova të besueshme nga Kallëzimi penal që e vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe Kërkesës për dhënjen e Urdhërit Ndëshkimor, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënjen e Urdhërit Ndëshkimor në kuptim të nenit 493 par.1 të KPPRK-së.

Gjykata, duke vlerësuar Kallëzimin penal të DBPZH-APK-Zyra në Ferizaj 43/2017 dhe Procesverbali I DBPZHR nr.374/2017 të dt.13.07.2017, të cilat gjinden në shkresat e lëndës vërtetoi pa mëdyshje se i pandehuri ka kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së .

Andaj, gjykata të njejtin e shpalli fajtor dhe konform nenit 495 të KPPRK-së i shqiptoi dënimin me gjobë të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prandaj, duke u mbështetur në nenin 498 të KPPRK-së , gjykata i shqiptoi të pandehurit dënimin me gjobë, pasi që gjykata vlerësoi shkresat e lëndës dhe konstatoi se ekzistojnë prova të besueshme se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe me aktgjykim me Urdhër ndëshkimor e ka shpallur fajtor dhe e ka denuar me dënim sipas ligjit.

Në bazë të nenit 458-460 të KPPRK-së, i pandehuri në emër të kërkesës pasuroro-juridike për kompensimin e dëmit të dëmtuarës Drejtoria për Bujqësi, pylltari-Zyra në Ferizaj obligohet që të ia kompensoj dëmin e shkaktuar në lartësi prej 310.50 euro.

Konform nenit 450-451 të KPPRK-së, i pandehuri është i obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.


Nga arsyet e lartëshenura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**P nr.1878/17, datë 09.01.2018**

**Zyr.ligjor**  
**Gazmend Bytyqi**

**Gjyqtari,**  
**Elmaz Zenuni**



**Këshilla juridike:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Kundërshtim në afat prej 8 dite nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës Themelore në Ferizaj.